



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Rishikim i legjislacionit lidhur me të drejtën për kompensim në rastet e dëmit të shkaktuar nga autoritetet publike në Kosovë

Shtator 2023





SUNDIMI I LIGJIT



Vizitoni ueb faqen tonë
www.dplus.org

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit,
lajmeve dhe infografikave online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@DemocracyPlus](https://www.youtube.com/DemocracyPlus)

Zyret tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org

Deklaratë mohuese: Kjo analizë është botuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Projekti "Promovimi i procedurave të drejta administrative për qytetarë dhe biznese" i financuar nga BE, implementohet nga Demokraci Plus (D+).



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Përmbajtja

Lista e shkurtesave	6
Hyrje.....	7
Metodologjia.....	8
Përmbledhje e të gjeturave.....	9
E drejta e kompensimit në rast të dëmit nga autoritetet publike në Kosovë.....	11
Zbatimi në praktikë	12
Kontributi i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në inicimin e rasteve për kompensim.....	13
Klasifikimi i rasteve të kompensimit	14
E drejta e kompensimit në rast të dëmit nga autoritetet publike në Shqipëri	15
drejta e kompensimit në rast të dëmit nga autoritetet publike në Mal të Zi.....	17
E drejta e kompensimit në rast të dëmit nga autoritetet publike në Estoni	17
Rekomandime	19

Lista e shkurtesave

ANJF →	Agjencia për Ndhmë Juridike Falas
BE →	Bashkimi Evropian
KE →	Këshilli i Evropës
KGJK →	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPMSHC →	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil
KPP →	Kodi i Procedurës Penale
LMD →	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve
LPPA →	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
LZP →	Ligji për Zyrtarët Publik
MD →	Ministria e Drejtësisë

Hyrje

E drejta për të kërkuar kompensim në rast të dëmit nga autoritetet publike është e drejtë dhe parim bazik që ka filllet në Kushtetutë. Sipas parimeve të përgjithshme të sistemit gjyqësor të definuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e drejta për ankesë ndaj vendimit gjyqësor është e garantuar me Kushtetutë. Prandaj, e drejta për kompensim përfshihet në garantimin e të drejtës për ankesë ndaj vendimit gjyqësor, kur pala e dëmtuar kërkon të drejtën e kompensimit pas vendimit të gjykatës me të cilin shpallet i/e pafajshëm apo palë e dëmtuar pa arsye apo pa të drejtë pavarësisht procedurës, penale, civile, apo administrative.

E drejta e kompensimit në vendet e ish-Jugosllavisë zakonisht është pjesë e Ligjit të detyrimeve apo sikurse në rastin e Kosovës, Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve. Kjo e drejtë në Mal të Zi është e rregulluar me Ligjin për detyrimet, po ashtu në Maqedoni të Veriut, Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë. Për shkak të një tradite tjetër, e drejta e kompensimit në rast të dëmit nga autoritetet publike në Shqipëri është e rregulluar në një formë tjetër, përmes Ligjit për Përgjegjësinë Jashtëkontraktore të Organeve të Administratës Shtetërore në një harmoni me Kodin Civil të Shqipërisë. Megjithatë, përveç ligjeve për detyrimet, këto vende e kanë garantuar të drejtën e kompensimit edhe përmes ligjeve tjera, për shembull, Kodit të Procedurës Penale dhe Ligjit procedurën e përgjithshme Administrative në Kosovë, Ligjit për administratën shtetërore në Mal të Zi, Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative dhe Ligjit për shërbimin civil në Maqedoninë Veriore.

Realizimi i të drejtës për kompensim është i rëndësishëm po aq sa garantimi i të drejtës për kompensim. Institucionet (gjyqësori, qeveria) nuk posedojnë të dhëna definitive sa i përket numrit të rasteve të iniciuara për kompensim, statusi i rasteve, llojet e kompensimit sepse zbatimi i kësaj të drejte nuk monitorohet nga to. Të dhënat e disponueshme në këtë rast në Kosovë janë të mangëta sidomos në procedurën civile apo në atë që quhet si raste civile sepse rastet e kompensimit të dëmit zakonisht njihen si raste civile. Kjo sepse klasifikimi i lëndëve në gjykata nuk mundëson ndarjen e lëndëve që janë vetëm për kompensim, pavarësisht procedurës, civile, penale. Për këto arsye, është e pamundur të evidentohet se sa e drejta e kompensimit në rast të dëmit nga autoritetet publike është duke u zbatuar në Kosovë.

Ministria e Drejtësisë ka hartuar koncept dokumentin për realizimin e të drejtave civile përfshirë të drejtën e palës për gjykim brenda kohës së arsyeshme, ku trajtohet e drejta e kompensimit. Mirëpo, këtu e drejta e kompensimit të palës trajtohet nga aspekti i dëmit që i shkaktohet palës për shkak të kohëzgjatjes së procedurës (pra mos gjykimet brenda kohës së arsyeshme) dhe nuk trajtohet e drejta e kompensimit pas përfundimit të procedurës apo pas vendimit të gjykatës kur pala pas vërtetimit të pafajshmërisë, mund të iniciojë kërkesë për kompensim për dëmin e shkaktuar e të vërtetuar përmes vendimit gjyqësor.

Metodologjia

Metodologjia për hartimin e raportit është përbërë nga hulumtimi online (desk research), intervistat e drejt-përdrejta dhe fokus grupet. Sa i përket hulumtimit online, janë hulumtuar dhe analizuar ligjet relevante në Kosovë sa i përket definimit të së drejtës së kompensimit ndaj personit i cili është dëmtuar si pasojë e veprimeve të autoriteteve publike. Në këtë aspekt, janë hulumtuar Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (relevant sidomos për të drejtën e kompensimit në procedurë civile), Kodi i Procedurës Penale (relevant sidomos për të drejtën e kompensimit në procedurë penale) dhe Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative (relevant sidomos për të drejtën e kompensimit në procedurë administrative).

Për të parë se si vendet tjera e kanë të rregulluar të drejtën e kompensimit në rastet e dëmit nga autoritetet publike, janë marrë si shembuj dy vende të rajonit (Shqipëria dhe Mali i Zi) dhe një vend anëtar i BE-së, Estonia. Ligjet relevante në këtë fushë për këto vende janë analizuar dhe të gjeturat rreth të drejtës së kompensimit janë elaboruar në këtë raport.

Për të analizuar edhe më tej se sa e drejta e kompensimit është e definuar me legjislacion në Kosovë, janë organizuar edhe intervista me akterë relevant në këtë fushë, si: Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit, Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas, Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe avokat që mbulojnë fushën e së drejtës administrative.

Për më shumë, me qëllim të diskutimit të kësaj të drejte dhe sa është i qartë dhe i mjaftueshëm legjislacioni në Kosovë mbi këtë çështje, është organizuar edhe një fokus grup me qytetarë dhe palë tjera relevante. Nga këto të fundit, vlenë të përmendet Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Instituti i Kosovës për Drejtësi, dhe avokat të pavarur të fushave të ndryshme. Pas hartimit të raportit si draft, është organizuar edhe një fokus grup tjetër me qëllim validimin e të gjeturave të këtij raporti.

Përmbledhje e të gjeturave

- Ekziston bazë ligjore në Kosovë mbi të drejtën e kompensimit të palës në rast të dëmit shkaktuar në autoritetet publike, përmes mirëpo jo vetëm: a) Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve; b) Kodit të Procedurës Penale dhe c) Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- Të tri ligjet si më lartë shërbejnë si bazë ligjore për të kërkuar të drejtën e kompensimit në rast të dëmit, në procedura të ndryshme: Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në procedurë civile, Kodi i Procedurës Penale në procedurë penale dhe Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative në procedurë administrative;
- Procedura e ankesës duke përfshirë kërkesën për kompensim në rast të dëmit në marrëdhënien shtet – zyrtar publik, është e rregulluar me legjislacion tjetër, përkatësisht Ligjin për zyrtarët publik. Zyrtarët publik me status të nëpunësit civil kanë si mekanizëm referues fillimisht Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (KPMSHC) e pastaj në gjykatë. Megjithatë, kjo marrëdhënie apo ky aspekt nuk është trajtuar në këtë punim pasi fokusi është në raportin shtet – person fizik në kuptimin jo në marrëdhënie të punës në administratën publike;
- Edhe pse ekziston bazë ligjore në bazë të së cilës mund të kërkohej kompensim në rast të dëmit, nuk janë mjaftueshëm të qartësuar disa elemente dhe ato sidomos në procedurë civile, si: procedura e kërkesës për kompensim duke përfshirë mekanizmat referues, llojet e kompensimit, buxheti dhe afati. Po ashtu, çështja se a mund të kërkohej kompensim në rast të dëmit nga autoritetet publike, kur veprimi ose mesveprimi i autoritetit publik është kryer me dashje apo pa dashje, nuk është e adresuar mjaftueshëm në legjislacion;
- Edhe kur inicohej raste për kompensim në rast të dëmit, kohëzgjatja mesatare e procedurës gjyqësore mesatare vlerësohet të jetë tetë (8) vite. Ministria e Drejtësisë ka hartuar koncept dokumentin për realizimin e të drejtave civile përfshirë të drejtën e palës për gjykim brenda kohës së arsyshme;
- Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është duke shërbyer si një mekanizëm i mirë referues për qytetarët në adresimin e kërkesave për kompensim në procedurë civile, administrative, penale, mirëpo është vlerësuar se numri i rasteve ndihmuar nga kjo agjenci në krahasim me nevojat për adresim të kërkesave të tilla, është i vogël;
- E drejta e kompensimit dhe procedura për realizimin e saj është më e qartë në procedurë penale dhe administrative, se sa në atë civile. Në procedurë penale, është definuar mekanizmi ku bëhet kërkesa, fondi, kohëzgjatja dhe raportimi mbi realizimin e kësaj të drejte ka filluar të përmirësohet nga viti 2022. Megjithatë, në procedurë penale, lartësia në vlerë monetare e kompensimit është vlerësuar e ulët në raport me dëmin e shkaktuar. Kjo për shkak se palët kompensohen për një ditë qëndrimi në burg me 9 € për dëm material dhe 6 € për dëm jo material;
- Qytetarët janë pak të informuar sa i përket të drejtës së tyre për të kërkuar kompensim në rast të dëmit nga autoritetet publike;
- Klasifikimi i rasteve dhe vendimeve në gjykata sa i përket kompensimit, nuk është i mjaftueshëm. Kjo sepse lëndët klasifikohen sipas tipologjive të mëdha, për shembull si: civile, penale, administrative, dhe disa të tjera, mirëpo nuk ka nën-klasifikime brenda lëndës se sa nga ato janë për kompensim.

■ E drejta e kompensimit në rast të dëmit shkaktuar nga autoritetet publike në Shqipëri është e rregulluar me Ligjin për Përgjegjësinë Jashtëkontraktore të organeve të Administratës Shtetërore. Ligji rregullon llojet apo rrethanat në të cilat organet shtetërore janë përgjegjëse karshi personave fizik dhe juridik, përcakton llojet e dëmshpërblimit, përcakton rastet kur administrata publike përjashtohet nga përgjegjësia, afatin e kërkesës për kompensim dhe si sigurohet buxheti (fondi) nga institucionet për të realizuar kompensimin e palës;

■ E drejta e kompensimit në rast të dëmit shkaktuar nga autoritetet publike në Mali të Zi është e rregulluar me Ligjin për Detyrimet dhe Ligjin për administratën shtetërore. Ligji rregullon llojet apo rrethanat në të cilat organet shtetërore janë përgjegjëse karshi personave fizik dhe juridik, përcakton rastet kur administrata publike përjashtohet nga përgjegjësia, dhe afati kohor për të kërkuar të drejtën e kompensimit;

■ E drejta e kompensimit në rast të dëmit shkaktuar nga autoritetet publike në Estoni është e rregulluar me Ligjin për Përgjegjshmërinë e Shtetit. E drejta e kompensimit në Estoni është e theksuar shprehimisht edhe në Kushteteten e këtij vendi. Edhe në këtë rast, ligji përcakton rrethanat apo llojet e dëmeve (pasurore, jo pasurore, ndaj personave të tretë), procedurat e kompensimit dhe afatin e kërkesës për kompensim në rast të dëmit nga autoritetet publike;

E drejta e kompensimit në rast të dëmit nga autoritetet publike në Kosovë

E drejta e kompensimit të personit (palës) në rast të dëmit nga autoritetet publike është e rregulluar me legjislacion në Kosovë. Në procedurën civile, kjo çështje është e rregulluar me Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve (LMD), përkatësisht Neni 153 garanton përgjegjësinë e personit juridik (në këtë rast shtetit) për dëmin e shkaktuar nga organi i tij. Sipas kësaj dispozite:¹

1. Personi juridik përgjigjet për dëmin të cilin organi i tij i'a shkakton personit të tretë gjatë ushtrimit ose lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij;
2. Në qoftë se për rastin e caktuar nuk është parashikuar ndryshe me ligj, personi fizik ka të drejtë në shpërblim nga personi i cili e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia e rëndë;
3. Kjo e drejtë parashkruhet brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh nga dita e pagimit të shpërblimit të dëmit.

Sipas kësaj, garantohet përgjegjësia e personit juridik për dëmin e shkaktuar personit fizik (pika 1 e nenit) dhe e drejta e personit fizik të kërkojë shpërblim për dëmin e shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë. Ky nen vlerësohet i mjaftueshëm sa i përket bazës ligjore në bazë të së cilës personi fizik (pala e dëmtuar) mund të kërkojë shpërblim në rast të dëmit të shkaktuar nga autoritetet publike. Ekzistimi i bazës së mjaftueshme ligjore në këto raste është konfirmuar dhe në fokus grupin e Demokraci Plus (D+) të organizuar me qytetarë dhe palë tjera.²

E drejta për të kërkuar kompensim personit juridik në rast të dëmit të shkaktuar nga autoritetet publike ka të bëjë edhe më faktin se për cilën procedurë bëhet fjalë, civile, penale, apo administrative. Sipas fokus grupit të organizuar,³ LMD dhe neni 153 shërben si bazë ligjore në procedurën civile, kurse baza ligjore në procedurën penale dhe procedurën administrative lidhet me Kodin e Procedurës Penale (KPP) për procedurën penale dhe Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA) për procedurën administrative. Edhe në këto procedura, nga pjesëmarrësit në fokus grup është vlerësuar se ekziston bazë e mjaftueshme ligjore mbi të drejtën e kompensimit në rast të dëmit nga autoritetet publike pavarësisht procedurës (penale, administrative, civile).

Në procedurë penale, KPP në Nenin 15 përcakton të drejtën në rehabilitim dhe kompensim të personit ndaj të cilit është marrë veprim i paligjshëm në procedurë penale. Sipas kësaj dispozite:⁴

1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Neni 153: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2828> (qasur për herë të fundit në qershor, 2023).

2 Fokus grup i organizuar me datë: 12 Maj 2023.

3 Ibid.

4 Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>



Çdo person i cili është dënuar, arrestuar, ndaluar ose paraburgosur në mënyrë të paligjshme ka të drejtë në rehabilitim të plotë, kompensim të drejtë nga mjetet buxhetore dhe në të drejta të tjera të parapara me ligj.

Kjo çështje është e rregulluar detajisht në kapitullin XXXVI mbi procedurën për kompensim dëmi, rehabilitimi dhe për ushtrimin e të drejtave të tjera të personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye. Sipas Nenit 526 të kapitullit përkatës, kërkesa për kompensim duhet të bëhet brenda tri (3) viteve pas formës së prerë të aktgjykimit të shkallës së parë me të cilin i akuzuari është liruar nga akuza. Mirëpo, kur për ankesë vendos gjykata më e lartë, e drejta për kompensim parashkruhet pas tri (3) vitesh nga dita e marrjes së vendimit nga gjykata e tillë. Sa i përket nisjes së procedurës për kompensim dëmi, sipas nenit 527 (pika 3), pala e dëmtuar fillimisht kërkesën e tij ia drejton organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore për arritjen e marrëveshjes për ekzistimin e dëmit, llojin dhe lartësinë e kompensimit.

Në procedurën administrative, e drejta e kompensimit të palës njihet te shfuqizimi i veprimeve administrative, konkretisht të aktit administrativ dhe kontratës administrative sipas LPPA⁵. Sipas Nenit 57, pika 3, në rast të shfuqizimit të aktit administrativ nga i cili vendim ka përfiturar pala, atëherë pala do të ketë të drejtën e kompensimit monetar nëse ka hyrë në marrëdhënie juridiko-civile nga të cilat nuk mund tërhiqet më, apo nga të cilat mund tërhiqet vetëm duke pësuar dëme, që nuk do të ishte e arsyeshme të kërkohen nga ajo. Pastaj, sipas pikës 4 të të njëjtit nen, masa e kompensimit nuk duhet të tejkalojë interesin e arsyeshëm që ka pala si-

kur akti i shfuqizuar të vazhdonte të prodhojë pasoja juridike. Pala nuk përfiton kompensim për fitimin e munguar. Po ashtu, në rast të shkëputjes së njënanshme të kontratës administrative në mes të organit publik dhe palës (personit fizik), kjo e fundit ka të drejtën e kompensimit për dëmet e pësuar.

Sa i përket të drejtës për kompensim në procedurë administrative, ky raport trajton vetëm të drejtën e kompensimit në marrëdhënien në mes të shtetit (administratës publike) dhe palës në cilësinë e personit fizik, por jo të drejtën e kompensimit në marrëdhëniën në mes të shtetit dhe zyrtarit publik i punësuar në administratën publike. E drejta e ankesës dhe kompensimit në rast të dëmit në këtë aspekt është e rregulluar me Ligjin për zyrtarët publik për të gjithë zyrtarët publik⁶. Në rastin e nëpunësit civil në kuadër të administratës shtetërore, ankesa ndaj organit publik inicihet nga zyrtari fillimisht në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (KPMShC) e në rast të mos pajtueshmërisë me vendimin e KPMShC, palët mund të iniciojnë konflikt administrativ pranë gjykatës administrative.

Zbatimi në praktikë

E drejta për kompensim zbatohet në Kosovë, mirëpo të dhënat që dëshmojnë se sa kjo e drejtë është duke u zbatuar, nuk janë të qarta dhe të mjaftueshme. Po ashtu, nuk ka të dhëna të mjaftueshme dhe të kategorizuara sipas llojit të procedurës sa i përket pagesave që janë bërë nga autoritetet publike ndaj palëve të dëmtuara në rastet e fitimit të drejtës për kompensim nga palët e dëmtuara. Përveq që nuk ka të dhëna se sa janë paguar dëmshpërblime sipas llojeve të procedurave (me përjashtim të procedurës penale), nuk ka të dhëna as sa raste janë për kompensim dëmi brenda procedurës civile.

Në procedurë civile, LMD nuk përcakton mekanizmat dhe procedurën për të kërkuar të drejtën e kompensimit. Për shembull, nuk përcaktohet se kujt i dorëzohet ankesa fillimisht, institucionit që ka shkaktuar dëmin sipas pretendimit të palës, apo gjykatës? Pastaj, në

5 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559> (qasur për herë të fundit në qershor, 2023).

6 Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=25839>

rast të fitimit të së drejtës për kompensim, kush e bënë kompensimin e palës së dëmtuar, institucioni që ka shkaktuar dëmin apo ekziston tjetër fond? Mungesa e mekanizmave të qartë për realizimin e kesaj të drejte (mos definimi i përgjegjësisë), problemet rreth kohëzgjatjes së procedurës dhe mungesa e fondit për kompensimin e palëve të dëmtuara është paraqitur si një prej problemeve edhe nga institucioni i Avokatit të Popullit.⁷

Në procedurë penale, kjo çështje është më mirë e rregulluar për shkak se ekziston mekanizmi ku inicohet kërkesa për kompensim, përkatësisht Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). KGJK ka themeluar Komisionin për kompensimin e dëmit për personat e dënuar, ose arrestuar pa arsye të përbërë nga nga 5 anëtarë (3 anëtarë të rregullt dhe 2 rezervë, përfshirë kryetarin si anëtar i rregullt). Po ashtu, sipas të dhënave nga KGJK, ekziston edhe fondi i caktuar për kompensimin e viktimave të cilët janë dënuar apo arrestuar pa arsye⁸. Kërkesat aktuale për kompensim për raste penale arrijnë në shumën prej 77 milion Euro, shifër relativisht e lartë për këtë institucion. Sfidë në këtë aspekt mbesin pa dyshim vonesat në trajtimin e rasteve të cilat në Gjykata mund të marrin deri në tetë vite, kohë e gjatë për të konsideruar si të suksesshme dhe drejtësi e realizuar. Situata do të mund të komplikohet edhe më tej në aspekt të kompensimit të fituar kur Kosova të anëtarësohet në Këshillin e Evropës (KE) dhe prej ku qytetarët rëndom mund të fitojnë raste të kompensimit më të lartë. Aktualisht, palët kompensohen me shuma relativisht të ulta në aspekt të mbajtjes së padrejtë në burg. Rregullorja aktuale përcakton që në palët kompensohen për një ditë qëndrimi në burg me 9 € për dëm material dhe 6 € për dëm jo material.⁹

Me ndryshimin e legjisllacionit, parashihet që këto shuma të rriten në masë të caktuar por që vlerat nuk janë ende definitive. Risi në aspekt të kompensimit është poashtu fakti që gjatë vitit paraprak janë fituar dy raste në Gjykatë nga palët e dëmtuara për kompensim moral, që hap një dimension tjetër të kompensimit

eventual,¹⁰ i ngjashëm me vendet tjera të trajtuara në këtë analizë. Sipas raportit të komisionit përkatës, në vitin 2022 janë kompensuar 104 raste ku janë kompensuar persona të cilët janë arrestuar apo mbajtur pa arsye. Sipas të njëjtit raport, vlera e kompensimit që është paguar në total është 251,302.00 euro. Raporti i vetëm publik i komisionit në fjalë është i vitit 2022 prandaj edhe nuk mund të nxjerren krahasime mbi fitimin e të drejtës së kompensimit me vitet tjera.

Për të evituar sa më shumë situatat e tilla për të cilat organet shtetërore janë në njohuri, Ministria e Drejtësisë (MD) ka hartuar një koncept dokument për realizimin e të drejtave Civile përfshirë të Drejtën e Palëve për Gjykim brenda kohës së arsyeshme, dokumenti i cili shtjellon problematikën e vonesave në gjykim dhe jep instruksione të qarta për përmirësim të gjendjes.¹¹ Dokumenti është në fazat e diskutimit të brendshëm institucional dhe do të shërbejë si udhërrëfyes për ndërhyrjet eventuale legjislative dhe administrative.

Kontributi i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në iniciimin e rasteve për kompensim

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) është një mekanizëm i cili është duke ndihmuar qytetarët të kenë qasje në drejtësi (ndihmë juridike falas) në procedurë civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.¹² Sa i përket numrit të rasteve në përgjithësi për ndihmë juridike falas të iniciuara me ndihmën e ANJF-së, sipas raportit vjetor të saj, në vitin 2022 janë iniciuar 5,861 lëndë në total (civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse). Mirëpo, vetëm 294 prej tyre janë iniciuar si kërkesa për kompensim të dëmit, dhe 247 prej tyre janë përfunduar kurse 47 tjera janë në procedurë në vitin 2022.

7 Takim/intervistë me Naim Qelaj, Avokat i Popullit dhe Burim Tahiri, Këshilltar i Lartë Juridik, datë: 02.06.2023.

8 Takim/intervistë me Astrit Hoti, Koordinator i Njësisë për Çështje Ligjore, Analiza dhe Hulumtime, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, datë: 7 Qershor 2023.


9 Ibid.

10 Ibid.

11 Takim/intervistë me Genc Nimoni, Shef i Kabinetit i Ministres së Drejtësisë, datë: 25.05.2023.

12 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2803>

TABELA 1: Rastet total, rastet për kompensim dëmi, të përfunduara dhe ende në procedurë sipas ANJF



Burimi: ANJF

Klasifikimi i rasteve të kompensimit

Gjykatat themelore në Kosovë publikojnë aktgjykimet/aktvendimet përmes faqeve të tyre zyrtare dhe i kategorizojnë ato sipas disa llojeve, si: penale, administrative, ekonomike, civile, civile trashëgimore, civile të ndryshme, e të tjera. Secili lloj përfshinë një numër të madh të aktgjykimeve/aktvendimeve, mirëpo nuk ka një nën-klasifikim brenda llojit të lëndës që tregon se cilat

lëndë janë aktgjykime/aktvendime mbi realizimin e të drejtës për kompensim. Sipas raportit vjetor për vitin 2022 të KGJK, numri i lëndëve që gjykatat themelore kanë pasur në punë gjatë vitit 2022 është 318,435 lëndë.¹³ Mos-klasifikimi i lëndëve sipas disa tipeve brenda llojit të lëndës është konfirmuar edhe nga Gjykata Themelore në Prishtinë.¹⁴

¹³ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti statistikor i gjykatave për vitin 2022: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114_RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf

¹⁴ Takim me Shaban Gërxhaliun, Administrator në Gjykatën Themelore, Prishtinë: 02.05.2023.

E drejta e kompensimit në rast të dëmit nga autoritetet publike në Shqipëri

E drejta e kompensimit në rastet e dëmit nga autoritetet publike në Shqipëri rregullohet përmes Ligjit për Përgjegjësinë Jashtëkontraktore të organeve të Administratës Shtetërore. Ligji në fjalë përcakton rrethanat dhe përgjegjësinë shtetërore ndaj palëve të dëmtuara nga veprimi apo mos veprimi i organeve shtetërore.¹⁵

Neni 3 i këtij ligji përcakton që: “Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktajnë palëve fizike a juridike private në rastet që vijnë:

- a) Kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme;
- b) Kur kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, por që sjellin dëmtimin e interesave të ligjshme të personave fizik a juridik privat;
- c) Kur, megjithëse kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, u shkaktajnë një dëm të pabarabartë subjekteve të cilëve u drejtohet ky veprim apo mosveprim;
- d) Kur, për shkak të mosfunksionimit të mjeteve teknike me të cilat organet e administratës shtetërore ushtrojnë veprimtarinë e tyre, persona fizik a juridik privat cenohen ne interesat e tyre te ligjshme;
- e) Kur u shkaktajnë një rrezik të vazhdueshëm personave fizik a juridik privat;
- f) Kur kryejnë një akt korruptiv gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre”.

Elementet e përcaktuara në këtë nen japin një gamë të gjerë të rrethanave në të cilat organet shtetërore janë përgjegjëse karshi personave fizik dhe juridik. Pjesë e rëndësishme e ligjit është edhe përgjegjësia vetjake e

punonjësve të organeve të administratës shtetërore. Ligji (Neni 4) përcakton rrethanat kur punonjësit shtetëror janë të liruar nga përgjegjësia vetjake kur elementet janë të përcaktuara sipas nenit 3. Në përjashtim të kësaj, punonjësit janë përgjegjës për dëmet kur ata kanë vepruar në keqbesim. Në rastet e tilla, kur vërtetohet veprimi në keqbesim, organi shtetëror punëdhënës, pas kompensimit të palës së dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërblimit që ka paguar.

Një dispozitë e tillë i vendos punonjësit publik në situatë të kujdesit më të shtuar karshi (mos) veprimeve të qëllimshme, pagesa e dënimeve mund të konsiderohet metodë efektive për të rritur kujdesin në angazhimin publik.

Në kreun e dytë, ligji përcakton llojet e dëmshpërbimit duke i ndarë ato në:

- Kthimi, në kuptim të kalimit fizik të një sendi ose me rivendosjen e një të drejte, gëzimi i së cilës ishte pezulluar për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të administratës shtetërore
- Shpërblimi – në pagimin e një sasive të hollash për të baraspeshuar një dëm, i cili nuk mund të ndreqet në mënyrë të drejtëpërdrejtë.
- Zhdukja e shkaqeve që sjellin dëmin – duke përcaktuar që organet shtetërore mënjanojnë pasojat nga ndryshimi i një situatë juridike ose faktike, duke rivendosur gjendjen e mëparshme, përveç në rastet kur kthimi në gjendjen paraprake është i pamundur. Në rastet kur shkaktohet dëm pasuror, administrata

¹⁵ Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore.

pranon kërkesën e të dëmtuarit për kompensim, në rastet kur kthimi në gjendjen paraprake është i pamundur.

Ligji në fjalë përcakton edhe rastet kur administrata shtetërore përjashtohet nga përgjegjësia. Në përgjithësi, ato lidhen me dëmet e shkaktuara të cilat nuk kanë mundur të evitohen edhe nëse ishte treguar kujdesi i duhur gjatë ushtrimit të funksioneve shtetërore. Përjashtimi nuk zbatohet në rastet e mosfunksionimit të mjeteve teknike.

Rastet kur dëmtimi është shkaktuar edhe nga veprimet ose mosveprimet e të dëmtuarit janë poashtu pjesë e trajtimit të këtij ligji. Dëmi i kompensuar në raste të tilla zbritet edhe nga masa e cila është shkaktuar nga i dëmtuari, dëm i cili vlerësohet nga ekspertët, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të Kodit të Procedurës Penale.

Ligji përcakton edhe formën e kompensimit ndaj të dëmtuarve jo drejtëpërdrejtë e që lidhet kryesisht me rastin e vdekjes, cënimit të paprekshmërisë trupore ose të shëndetit, si dhe ne rastin e heqjes së padrejtë të lirisë. Në raste të tilla, kompensimi në të holla bëhet ndaj palëve të treta, në shtëpi apo në punën e tij, ndaj të cilëve i dëmtuari ka pasur obligime dhe të cilëve u shkaktohen dëme nga shërbimet e përcaktuara. Theks të veçantë iu jepet rasteve kur i dëmtuari i vdekur nga veprimi ose mos veprimi i administratës shtetërore ka obligime në mbajtjen e familjes dhe si rrjedhojë ata kanë mbetur pa të hyra. Në raste të tilla, përcaktohet shuma e pensionit në të holla si formë dëmshpërblimi për të dëmtuarin.

Ligji ka të përcaktuar qartë edhe përgjegjësinë e pushtetit të deleguar (kur subjekti që shkakton dëmin nuk është organ i administratës shtetërore, por vepron në bazë të autorizimit nga pushteti publik), ku përcaktohet që përgjegjësia i takon autoritetit publik dhënë të autorizimit. Në rast që vërtetohet që dëmi është shkaktuar nga pushteti i deleguar, autoriteti delegues mund të kërkojë dëmshpërblim.

Ligji ka përcaktuar si afat 3 vjeçar kohën brenda së cilës pala e dëmtuar mund të kërkojë dëmshpërblim, nga periudha kur i dëmtuari njoftohet për dëmin e kërkuar dhe organin që e ka shkaktuar atë. Periudha më e largët për kompensim për shkaktim të dëmit duhet të realizohet në mundësinë më të afërt financiare, në të kundërtën hyjnë si zë i veçantë në ligjin e buxhetit të shtetit në vitin pasardhës.

Sipas Nenit 12, në fund të çdo viti financiar, organet buxhetore dorëzojnë në Ministrinë e Financave, së bashku me kërkesën për financim nga buxheti i shtetit edhe kërkesën për sigurimin e fondeve buxhetore për detyrimet e tyre ndaj personave privat.

Përveq ligjit përkatës, edhe një nen i veçantë në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë përcakton rastet kur personi ka të drejtë në dëmshpërblim. Sipas Nenit 625, mbi përgjegjësinë për dëmin jopasuror, personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur:

- a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij;
- b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij;
- c) është cenuar e drejta e emrit;
- ç) është cenuar respektimi i jetës private;
- d) është cenuar kujtimi i një të vdekuri. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror”.¹⁶

16 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013.

E drejta e kompensimit në rast të dëmit nga autoritetet publike në Mal të Zi

Mali i Zi e ka rregulluar çështjen e të drejtës së kompensimit në kuadër të Ligjit për Detyrimet,¹⁷ i cili në një pjesë e veçantë definon të drejtën e kompensimit të dëmit (Pjesa 2: Kompensimi i Dëmeve (Mospajtimi Civil), si dhe përmes Ligjit për Administratën Shtetërore.¹⁸

Në parimet e përgjithshme të Ligjit për Detyrimet definohet qartë që kushdo që shkakton lëndime apo humbje tjetrit do të jetë përgjegjës për ta kompensuar atë, përveç nëse e dëshmon që dëmi nuk është shkaktuar me fajin e tij. Përgjegjësia bie mbi shkakтарin në rastet kur aktiviteti apo objekti shkakton dëm tek pala tjetër. Ndërsa Neni 7 i Ligjit për Administratën shtetërore specifikon që Republika është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar nga puna e paligjshme ose e pasaktë e organit të administratës shtetërore.

Dëmtimi ose humbja është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (humbje e thjeshtë) dhe parandalimi i rritjes së saj (humbje e fitimit), si dhe shkaktimi i tjetrit dhimbje fizike ose psikologjike ose shkaktimi i frikës, si dhe cenimi i të drejtave të personit dhe reputacionit të personit juridik. (pa dëme materiale). Definimi i dëmit konsiderohet pakësimi i pronës së dikujt apo ndalimi i fitimit, si dhe duke shkaktuar dhunë fizike e psikologjike, cënim të drejtave personale dhe reputacionit të entitetit legal (dëme jo materiale).

Ligji përcakton poashtu të drejtën e secilës palë të kërkoj nga tjetri t'i largoj një burim rreziku që i kanoset atij apo një numri personash, si dhe të parandaloj veprimtari që mund të shkaktojë rrezik apo humbje të caktuara. E drejta për t'u drejtuar në gjykatë ose organe tjera kompetente për të kërkuar që një e drejtë e mohuar të kthehet në vend, duke përfshirë mos cënimin e sigurisë fizike, integritetit moral si dhe reputacionit. Ndërsa, ligji mbi administratën përcakton poashtu rregullat sipas së cilës qytetarët mund të ankohen për shkelje të drejtave nga (mos) veprimi institucional, duke definuar qartë formën e ankesës (me shkrim, përmes kutisë së ankesave) dhe afatin e përcaktuar ligjor (brenda 15 ditësh) në përgjigje të ankesës së deponuar nga pala.



Definimi i dëmit konsiderohet pakësimi i pronës së dikujt apo ndalimi i fitimit, si dhe duke shkaktuar dhunë fizike e psikologjike, cënim të drejtave personale dhe reputacionit të entitetit legal (dëme jo materiale).

¹⁷ Ligji për detyrimet të Malit të Zi (Law on obligations) publikuar në Gazetën Zyrtare 47/2008 me 7 Gusht 2008.

¹⁸ Ligji për Administratën Shtetërore të Malit të Zi (the Law on Public Administration), publikuar në 2 Gusht 2003: <https://www.gov.me/en/documents/25c41b32-fca3-4c73-b561-fbc94af1f790>

Përgjegjësia ekziston nëse një palë ka shkaktuar me apo pa qëllim dëmtim të palës tjetër. Gjykata më pastaj vendos masat varësisht nga niveli i dëmit të shkaktuar por edhe nga përgjegjësia dhe mundësia e palës për të evituar atë problem.

Ligji përcakton poashtu rrethanat në të cilat pala përjashtohet nga përgjegjësia dhe është e ngjashme me rastet e vendeve tjera. Pala mund të përjashtohet nga përgjegjësia në rastet kur dëshmohet që evitimi i rastit ka qenë i pamundur dhe i pa evitueshëm.

Ligji mes tjerash përcakton edhe rastet kur shteti dësh-ton të reagoj sipas funksioneve të tij. Neni 87 i Ligjit për detyrimet përcakton që “shteti, agjencitë e të cilit, në përputhje me rregulloret ekzistuese, ishin të detyruara të parandalonin dëmtimin ose humbjen, do të jetë përgjegjës për humbjen për shkak të vdekjes, lëndimit trupor ose dëmtimit ose shkatërrimit të pronës së një individi për shkak të akteve terroriste, si dhe gjatë rrjedhës së demonstrata publike dhe ngjarje publike”. Në rastet kur dëmi shkaktohet nga palë të treta, shteti ka të drejtë të kërkoj kompensim nga shkaktuesi i dëmit.

Në këtë ligj janë të definuara edhe përgjegjësitë e organizatorëve të protestave, manifestimeve të ndryshme përmes së cilave qytetarët mund të lëndohen. Përgjegjësia është e definuar qartë përmes ligjit duke definuar të gjitha rastet e dëmtimeve eventuale nga aktivitetet e tilla.

Edhe në rastin e Malit të Zi, periudha kur pala mund të kërkoj dëmshpërblim është 3 vjet nga afati kur ajo është e informuar ose duhet të ishte informuar për dëmin e shkaktuar.

E drejta e kompensimit në rast të dëmit nga autoritetet publike në Estoni

Estonia si shtet anëtar i BE-së që nga viti 2004 e ka të rregulluar të drejtën e kompensimit në rastet e dëmeve nga autoritetet shtetërore përmes Ligjit për Përgjegjshmërinë e Shtetit¹⁹ i cili është në fuqi nga 1 Janari 2002. Për më shumë, Kushtetuta e Republikës së Estonisë në Nenin 25 përcakton që: “Secili ka të drejtën e kompensimit për dëmin e paprekshëm dhe atë të prekshëm që ai ose ajo ka pësuar për shkak të veprimeve të paligjshme të çdo personi”.²⁰

Ligji në fjalë, në dispozitat e përgjithshme përcakton bazat e detyrimeve duke definuar që:



Personi, të drejtat e të cilit janë shkelur nga aktivitetet e paligjshme të një autoriteti publik në një marrëdhënie të së drejtës publike (në tekstin e mëtejme pala e dëmtuar) mund të kërkojë kompensim për dëmin e shkaktuar personit nëse dëmi nuk mund të parandalohet dhe nuk mund të eliminohet me mbrojtjen ose rivendosjen e të drejtave”.²¹

Ligji përcakton normat e kompensimit për dëme pasurore, jo pasurore dhe për kompensime ndaj personave të tretë. Dëmet pasurore kompensohen në shumën në të cilën i dëmtuari do të përfitonte në rast që dëmi të mos ishte shkaktuar. Këtu janë të definuara qartë edhe mbulueshmëria e shërbimeve mjekësore eventuale të shkaktuara nga dëmi dhe rastet kur i dëmtuari humb aftësinë për punë shkak i lëndimit të përcaktuar.

Tek dëmet jo pasurore kategorizohen të gjitha dëmet e shkaktuara nga (mos) veprimet e ndërmarra të cilat kanë degraduar dinjitetin, kanë dëmtuar shëndetin, kanë privuar lirinë, konfidencialitetin dhe reputacionin e mirë që personi i dëmtuar ka pasur. Shuma e kompensimit për rastet e tilla është përcaktuar në proporcion me masën e dëmit të shkaktuar dhe duke marr parasysh formën dhe madhësinë e gabimit.

Ligji ka sqaruar edhe procedurat për kërkesë kompensimi nga palët e treta për dëmet e shkaktuara ndaj të dëmtuarit. Ai parasheh mundësinë për kompensim përmes konfirmimit të humbjes së mbështetjes financiare që pala e dëmtuar ka siguruar dhe dëmet jo pasurore duke u bazuar në të drejtën private. Në raste të caktuara, palët mund të kërkojnë që në vend të kompensimit financiar, autoritetet publike të rregullojnë bazën ligjore përmes së cilës ata janë dëmtuar nga (mos) veprimet përmes ndryshimit të ligjeve apo akteve të caktuara që kanë shkaktuar dëmin.

¹⁹ Ligji për përgjegjshmërinë e shtetit (State Liability Act): https://www.riigiteataja.ee/en/compare_original/507062016001

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Estonisë, Neni 25. Hyrë në fuqi me 3 Korrik 1992: <https://www.riigiteataja.ee/en/eli/521052015001/consolidate>

²¹ Ligji për Përgjegjshmërinë e Shtetit, Kapitulli 3, Kompensimi i dëmeve, Dispozitat e përgjithshme: [https://www.riigiteataja.ee/en/compare_origi-
nal/507062016001](https://www.riigiteataja.ee/en/compare_original/507062016001)

Në rastin e Estonisë, është e përcaktuar qartë përgjegjësia kur veprimet kryhen nga palë të treta të cilat marrin autorizim nga institucionet shtetëore. Në rast të tillë, përgjegjësia e dëmit është mbi institucionin delegues. Megjithatë, dallim mbetet fakti që personat fizik që ushtrjnë detyra publike nuk janë përgjegjës në aspekt të kompensimit përveç nëse një gjë e tillë rregullohet me ligje tjera. Përgjegjësia kufizohet edhe në rastet e institucioneve nëse dëmi i shkaktuar ka qenë i pamundur të evitohet edhe nëse të gjitha masat ishin ndërmarr.

Një person fizik, sipas ligjit në fjalë, mund të kërkojë kompensim për dëmin e shkaktuar gjatë procesit gjyqësor, duke përfshirë dëmin e shkaktuar nga një vendim gjyqësor, vetëm nëse një gjyqtar ka kryer një vepër penale gjatë procesit gjyqësor. Ligji ka rregulluar edhe rastet e dëmeve të shkaktuara nga aktet ose masat administrative duke definuar të drejtën për kompensim për dëmet nga aktet e tilla që kufizojnë në mënyrë të jashtëzakonshme të drejtat themelore të personit. Përrjashtime në të drejtën për kompensim, përveç elementeve tjera, bëhet në rastet kur kufizimi i të drejtave ose lirive themelore është shkaktuar nga personi ose kufizimi ka qenë në interes të personit.

Ligji ka të përcaktuar edhe procedurat për kompensim të dëmeve duke definuar qartë obligimet institucionale në raste të tilla si dhe adresat e qarta se ku duhen drejtuar ankesat. Kërkesa për kompensim e cila i adresohet autoritetit administrativ i cili ka shkaktuar dëmin (ose është përgjegjës për dëmin) duhet të adresohet brenda 2 muajsh nga ta. Në rast kur një gjë e tillë vonohet, pala e dëmtuar mund ta dërgoj rastin në Gjykatën Administrative brenda 30 ditësh për vlerësim të rastit apo për urdhëresë të pagesës së dëmshpërblimit.

Edhe në këtë ligj, periudha e përcaktuar për kërkim të dëmshpërblimit është 3 vite prej kur pala e dëmtuar është e informuar për dëmin e shkaktuar por jo më vonë se 10 vite nga periudha kur dëmi është shkaktuar, edhe nëse i dëmtuari nuk është në dijeni për palën që ka shkaktuar rastin. Ligji përgjithësisht është mjaft i kompletuar dhe mbulon një gamë të gjerë të rasteve të kompensimeve eventuale dhe mund të merret për bazë për amandamente eventuale nga autoritetet në Kosovë.

Rekomandime

Përgjithësisht, Kosova ka bazë ligjore të konsoliduar në aspekt të së drejtës së kompensimit në të tri nivelet: civile, penale dhe administrative. Vendi synon anëtarësimin në Këshillin e Evropës, një organizëm i cili u jep qasje qytetarëve të vendit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një mekanizëm mjaft efikas për të trajtuar rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut nga vendet anëtare, e drejtë e mohuar deri më tash për qytetarët e Kosovës. Anëtarësimi eventual në këtë mekanizëm është mjaft pozitiv por duhet nxitur institucionet të reagojnë më fuqishëm në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut që janë në domenin e punës së gjykatës.

Hulumtimi empirik mbi temën, intervistat dhe fokus grupi kanë nxjerrur rekomandimet e mëposhtme për veprim në avancim të së drejtës për kompensim në rastet e dëmeve të shkaktuara nga autoritetet publike në Kosovë:

- 1** Kosova duhet të forcoj sa më shpejtë mekanizmat që sigurojnë gjykim në kohë të arsyeshme për palët e përfshira. Si një prej të drejtave themelore, gjykimi në kohë të arsyeshme është respektim i dinjitetit njerëzor të palëve të përfshira dhe ul poashtu hapësirën dhe nevojën për kompensim të dëmit material dhe jo material.
- 2** Në aspektin e së drejtës civile, Legjislacioni Primar (Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Neni 153) duhet të plotësohet me legjislacion sekondar që sqaron më tej procedurat dhe mundësitë për kompensim në rastet e dëmeve të shkaktuara nga autoritetet publike, siç është e rregulluar në vendet e prezantuara në këtë analizë.
- 3** Për të nxjerrur legjislacion sekondar gjithëpërfshirës, por edhe për zbatim më të mirë të këtij ekzistues është i nevojshëm thellimi i bashkëpunimit institucional në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- 4** Gjykatat përkatëse duhet të klasifikojnë lëndët në realizimin e së drejtës për kompensim. Në këtë formë, do të ishte më e lehtë të adresoheshin rastet dhe të bëhen analiza mbi sasinë dhe elemente të tjera të rasteve të tilla në mënyrë që të ketë strategji për trajtimin e tyre.
- 5** Legjislacioni lidhur me të drejtën për kompensim në rastet e dëmeve të shkaktuara nga autoritetet publike duhet promovuar më tej te qytetarët e Kosovës. Një pjesë e madhe e tyre nuk kanë njohuri mbi të drejtat e tyre në rastet e dëmeve të shkaktuara, prandaj fushatat e informimit përmes diskutimeve, tryezave, fushatave senzibilizuese dhe formave tjera nga organizatat e shoqërisë civile, janë të nevojshme për ngritjen e vetëdijes në këtë aspekt.



Financuar nga
Bashkimi Evropian

